VENDIM
Nr.55, datë 25.8.2010

PËR SHTYRJEN E AFATIT PËR REALIZIMIN E KUSHTEVE TË VENDOSURA NGA ERE SHOQËRISË "E-VENTO SRL ALBANIA" SHPK

Në mbështetje të neneve 9, 13, pika 1 germa "a", dhe 15 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 121 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.2008 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 25.8.2010, pasi shqyrtoi informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqërisë "E-Vento S.r.l Albania" sh.p.k,

Dhe duke konsideruar:

Kompleksitetin e problematikës që i licencuari ka hasur për kryerjen dhe dorëzimin e studimit të fizibilitetit të bazuar në matje reale dhe duke qenë se ndërtimi dhe instalimi i parqeve eolike, përveç vonesave administrative në të cilat ka kaluar, ka pësuar edhe dëmtime gjatë këtij viti,

VENDOSI:

1. Të shtyjë me 24 muaj afatet e përcaktuara në vendimin nr.63, datë 22.9.2009 "Për shtyrjen e afatit për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqërisë "E-Vento s.r.l Albania" sh.p.k.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta